

RREGULLAT E REJA TË SIGURIMIT NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS

UDHËZIM I SHKURTËR PËR UDHËTARËT

Për t'ju mbrojtur prej kërcënimeve nga eksplozivët e lëngshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka nxjerr rregulla të reja të cilat e kufizojnë sasinë e materieve të lëngshme që mund t'i kaloni nëpër pikat kontrolluese të sigurimit. Këto rregulla vlejnë për të gjithë udhëtarët që nisen nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP).

Kjo do të thotë që, në pikat kontrolluese të sigurimit, ju dhe bagazhi juaj i dorës duhet të kontrolloheni për materie të lëngshme si dhe artikuj tjerë të ndaluar. Sidoqoftë, udhëtarët që nuk i ndërrojnë aeroplanët në ndonjë aeroport në Bashkimin Evropian (BE), Zvicër, Norvegji, ose Islandë, ende mund të blejnë materie të lëngshme apo xhelatinoze në "Duty Free Shop" të ANP-së.

Rregullat e reja hyjnë në fuqi prej të hënës, 6 nëntor 2006

ÇFARË KA NDRYSHUAR ?

Gjatë paketimit

Juve ju lejohet që të merrni vetëm sasi të vogla të materieve të lëngshme në bagazhin tuaj të dorës. Këto materie të lëngshme duhet të jenë në enë të ndara me kapacitet maksimal prej 100 ml secila. Këto enë duhet t'i paketoni në një qese plastike të tejdukshme që mund të hapet dhe mbyllet, me kapacitet jo më të madh se një litër për udhëtar (shih foton më poshtë).

Në aeroport

Për t'i ndihmuar personelit të sigurimit që t'i dallojnë materiet e lëngshme, ju duhet të :

- ✦ prezantoni të gjitha materiet e lëngshme te personeli i sigurimit në pikën kontrolluese për ekzaminim ;
- ✦ zhvisheni xhakëtën dhe/ose pallton. Ato do të kalohen ndaras nëpër makinën me rreze X derisa ju kaloni nëpër detektorin e metalit;
- ✦ nxirrini kompjuterët laptop dhe pajisjet tjera të mëdha elektrike nga bagazhi juaj i dorës. Ato do të kalohen ndaras nëpër makinën me rreze X derisa ju kaloni nëpër detektorin e metalit.



Materiet e lëngshme përfshijnë:

- ujin dhe pijet tjera, supat, shurupet
- kremrat, locionet dhe vajrat
- parfumet
- sprejet
- xheli, përfshirë edhe xhelin për flokë dhe dush
- përmbajtjet e kanaçeve me presion, përfshirë shkumën e rrojës, llojet tjera të shkumës dhe deodorantet
- pastat, përfshirë pastën e dhëmbëve
- përzierjet e materieve të lëngshme me të ngurta
- mascara
- çdo artikull tjetër me përbërje të ngjashme

ÇFARË NUK KA NDRYSHUAR ?

Ju edhe më tej mund të :

- ✦ paketoni materiet e lëngshme në bagazhin që e dorëzoni në "check in" – rregullat e reja vlejnë vetëm për bagazhin e dorës ;
- ✦ mbani në bagazhin tuaj të dorës barnat dhe racionet ushqimore të domosdoshme, përfshirë ushqimin për bebe, për përdorim gjatë fluturimit. Mund t'ju kërkojnë që të ofroni dëshmi për domosdoshmërinë e tyre;
- ✦ blini materie të lëngshme si pije dhe parfume në "Duty Free Shop" të ANP-së, nëse nuk i ndërrojnë aeroplanët në ndonjë aeroport në BE, Zvicër, Norvegji, ose Islandë.
- ✦ blini materie të lëngshme si pije dhe parfume në "Duty Free Shop" të ANP-së, edhe nëse i ndërrojnë aeroplanët në ndonjë aeroport në BE, Zvicër, Norvegji, ose Islandë, me kusht që këto materie të lëngshme të jenë në enë të ndara me kapacitet maksimal prej 100 ml secila dhe të paketuara në një qese plastike të tejdukshme, të përmendur më lart. .

Të gjitha këto materie të lëngshme mund t'i merrni si shtesë të sasisë në qesen plastike që mund të hapet dhe mbyllet, të përmendur më lart .

Nëse keni ndonjë dyshim, ju lutemi ta pyesni personelin e aeroportit, kompanisë ajrore apo agentin tuaj të udhëtimit para fluturimit .

Ju lutemi të keni mirësinë dhe të bashkëpunoni me sigurimin e aeroportit dhe personelin e kompanisë ajrore .